

Republika e Serbisë
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
Drejtoria e policisë

PU _____

PS/PI _____

Data: _____

Vendi: _____

TË DREJTAT E PERSONAVE TË PRIVUAR NGA LIRIA
(sipas nen.227 i Kodit të procedurës penale)

Policia mundë t'ju privoj nga liria nëse në Kodin e procedurës penale ekziston ndonjëra prej arsyeve të parapara për caktimin e paraburgimit, por është e obliguar që, pa vonesë e më së largu në afat prej tetë orëve, t'ju paraqes para gjykatësit hetues, përveç në rastin e mbajtjes.

Gjatë privimit nga liria policia kundër juve mund të përdor mjetet e detyrimit për parandalimin e lëndimit të vetes tuaj apo dikë tjetër, të kryeni veprë tjetër penale, të tentoni të fshiheni apo të ikni.

Policia është e obliguar që menjëherë pas privimit nga liria t'ju njoftoj në gjuhën tuaj ose në gjuhën të cilën e kuptoni lidhur me arsyet e privimit nga liria dhe për të gjitha që ju vë në ngarkesë, si dhe t'ju udhëzojë mbi të drejtat e juaja ligjore:

- që nuk jeni i obliguar të deklaroni asgjë dhe çdo gjë që deklaroni mund të përdoret kundër juve si dëshmi;
- që keni të drejtë në mbrojtësin sipas zgjedhjes tuaj, që pa pengesa të kontaktoni me mbrojtësin, që mbrojtësi të merr pjesë gjatë hetimit tuaj;
- që të kërkonit që për kohën, vendin, dhe çdo ndryshim në vendin e privimit nga liria, të njoftohen pa vonesë personat sipas zgjedhjes tuaj, si dhe përfaqësuesi konsularo -- diplomatik i shtetit shtetas i të cilit jeni, gjegjësisht përfaqësuesin e organizatës ndërkombëtare, nëse jeni refugjat ose person pa shtetësi;
- që pa pengesa të kontaktoni me përfaqësuesin konsularo – diplomatik gjegjësisht me përfaqësuesin e organizatës ndërkombëtare ose Mbrojtësin e qytetarit;
- të kërkonit në çdo kohë që pa vonesë t'ju kontrolloj mjeku sipas zgjedhjes tuaj e nëse ai nuk ka mundësi sipas zgjedhjes suaj, atëherë sipas zgjedhjes së policisë;
- të inicioni procedurën para gjykatës për ligjshmërinë e privimit të lirisë tuaj;
- të kërkonit kompensimin e dëmit për privimin tuaj kundërligjor të lirisë.

Zyrtari i policisë _____ dita _____ në ora _____, në lokalet zyrtare _____, pas privimit nga liria

(emërtimi i njësisë organizative)

m'i ka komunikuar të drejtat dhe dorëzuar kopjen e formularit «e drejta e personit të privuar nga liria» të cilin e kam lexuar – refuzuar të lexoj.

nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

nënshkrimi i personit të privuar nga liria

Vërejtja:

Në qoftë se personi nuk ka lexuar ose ka refuzuar të lexojë formularin, të ceket arsyeja dhe të konstatohet që personi në mënyrë gojore është udhëzuar për të gjitha të drejtat e tij ligjore: _____

Në qoftë se personi refuzon të nënshkruajë formularin që e ka lexuar, të ceket arsyeja:
